



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TIRANE
NJESIA ADMINISTRATIVE BERZHITE

Nr.____Prot.

Tiranë, më____/____2017

Proçes verbal

Sot, në date 23.11.2017 u mbajt dëgjese publike në ambjentet e Njesisë Administrative Bërzhitë me tematikë **“Buxheti për vitin 2018”** për Njësinë Administrative Bërzhitë, Bashkia Tiranë. Në këtë takim ishin të pranishëm: Administratori i Njesisë Administrative Bërzhitë **z.Refik Velija, z.Erind BEJKO**, Drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimi i Njësive Administrative dhe Emergjencat Civile. Të pranishëm të tjerë ishin ndërlidhësit me komunitetin, punonjësit e Njesisë Administrative Bërzhitë si dhe qytetarë nga kjo njësi.

Programi i këtij takimi:

Z.Refik Velija, Administrator i Njesisë Administrative Bërzhitë, pasi falenderoi të gjithë pjesëmarrësit përmendi edhe investimet që aktualisht po bëhen dhe janë bërë në këtë njësi:

- Rehabilitimi i rugës në fshatin Pëllumbas.
- Ndertimi i shkollës 9- vjecare në fshatin Mihajas.

Falenderimi gjithashtu shkon për Bashkinë e Tiranës, dhe drejtoritë e caktuara për mbështetjen e dhënë.

Kërkesat për vitin e ardhshëm janë:

- Ndërtimi i trotuareve dhe vendosja e ndricimit në qendrën e fshatit Bërzhitë.
- Përfundimi i punimeve në urën e bonarakëve, që do mbyllet brënda 2018.
- Rikonstruksioni i palestrës së shkollës 9- vjecare në Fshatin Bërzhitë, si dhe krijimi i këndeve sportive.

Z.Erind BEJKO, Drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimi i Njësive Administrative dhe Emergjencat Civile. Bashkë me falenderimet për pjesëmarrjen Z.Bejko përmendi investimet që janë bërë dhe do të bëhen nga Bashkia Tiranë, parashikime këto që për vitin e ardhshëm do të ruajnë të njëjtën vlerë si viti që lamë pas.

Nga z.Bejko u përmendën këto investime për vitin 2018:

- Ndërtimi i trotuareve dhe vendosja e ndricimit në qendrën e fshatit Bërzhitë.
- Përfundimi i punimeve në urën e bonarakëve, që do mbyllet brënda 2018.
- Rikonstruksioni i palestrës së shkollës 9- vjecare në Fshatin Bërzhitë, si dhe krijimi i këndeve sportive.

Diskutimet vazhduan në formë bashkëbisedimi rreth prioriteteve midis qytetarëve dhe përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë.

Qytetari, z.Behar Hasmuca- Ngrej shqetësimin për transportin e udhëtarëve për fshatrat Killojkë-Fravesh-Pashkashesh, të cilët që nga dita e hënë me dt.20.11.2017 është pezulluar. Nuk kemi mundësi lëvizje pasi furgonat që bënin transportin e banorëve nuk lëvizin pasi ju ka përfunduar licensa. Kërkojmë të zgjidhet sa më shpejt kjo gjëndje pasi kanë mbetur pa shkollë fëmijët të cilët studiojnë në Tiranë, gjithashtu dhe punëtorët kanë mbetur pa punë .

Qytetari, Sami Sinakoli- Shpreh shqetësimin për mungesën e transportit të udhëtarëve në fshatrat Killojkë-Fravesh-Pashkashesh. Kërkojmë një takim me përfaqësuesit e drejtorive të transportit në Bashkinë e Tiranës.

Gjuthashtu problematike është dhe segment i pa asfaltuar në fshatin Fravesh Killojkë me gjatësi rreth 4 km.

Problematika e kanalit vaditës në fshatin Killojkë, i cili është amortizuar ndër vite. Ka nevojë për investim pasi është jetik për banorët e zonës.

Qytetari, Riza Abdija- Ngre shqetësimin e mungesës së ujit të për fshatin Lugë-Shalqizë. Infrastruktura rrugore është shumë e keqe dhe në ditët me shi ndodh shpesh që të bllokohet qarkullimi i makinave. Ndërsa për fshatin Kusë kërkojmë ndërtimin e një depoje uji.

Qytetari, Durim Duqi- Shqetësimi jonë është mbyllja e kopështit në shkollën fillorë të fshatit Pëllumbas, kërkojmë rihapjen sa më shpejt.

Mbledhja u mbyll me një falenderim për të gjithë pjesëmarrësit!

**ADMINISTRATORI
REFIK VELIJA**